



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 67

Tiranë – E hënë, 3 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 29.3.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar..... 3689
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 13.3.2017	Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore..... 3690
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 11, datë 13.3.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 3.5.2010, “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale” 3691
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 46, datë 28.3.2017	Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike” 3695
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 6854/13, datë 27.3.2017	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme, të tipit “tokë bujqësore arë, truall dhe ndërtesë”, që preken nga “Ndërtimi i rrugës Gramsh-Dushk, pjesë e projektit të hidrocentraleve mbi lumin Devoll”..... 3700

**VENDIM****Nr. 268, datë 29.3.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 748, DATË 11.6.2009, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI
PAGË PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT
AKADEMIK NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Në pikën 7, pagesa për çdo orë mësimore mbi normën e miratuar me dispozitë, e përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të kësaj pike, ndryshon, si më poshtë vijon:

“a) Kur janë në kategorinë “Profesor”, përfitojnë 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

Kur janë në kategorinë “Profesor i Asociuar”, përfitojnë 1 210 (një mijë e dyqind e dhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

Kur janë në kategorinë “Docent”, përfitojnë 1 100 (një mijë e njëqind) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

ç) Kur janë “Lektor i parë”, përfitojnë 880 (tetëqind e tetëdhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

d) Kur janë “Lektor”, përfitojnë 660 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave, të përcaktuara në ligjin nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****Lidhja nr. 1**

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK,
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Nr. rendor	Pozicioni	Paga
1	Rektor (titullar institucioni)	139800
2	Zëvendësrektor, nga kategoria “Profesor”	132200
3	Zëvendësrektor, nga kategoria “Docent”/“Doktor”	130500
4	Dekan nga kategoria “Profesor”	132200
	Dekan nga kategoria “Docent”/“Doktor”	130500
5	Zëvendësdekan, nga kategoria “Profesor”	121000
6	Zëvendësdekan, nga kategoria “Docent”/“Doktor”	106700
7	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Profesor”	123800
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Docent”/“Doktor”	106700
9	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria “Profesor”	123800
10	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria “Docent”/“Doktor”	106700
11	Profesor	121000
12	Profesor i asociuar	105200



13	Docent (Doktor)	95800
14	Docent (Master)	91800
15	Lektor i parë/Kërkues i parë	90300
16	Lektor/Kërkues	73400

UDHËZIM

Nr. 8, datë 13.3.2017

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 9, pika 4 dhe nenit 10, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 8, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 9 dhe 10, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”,

UDHËZOJ:

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), është institucion publik i krijuar me ligj, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar.

2. QSHA-ja ka për objekt veprimtarie ofrimin e shërbimeve për nxënësit, studentët, kandidatët për të marrë titullin e një profesioni të rregulluar, shkollat, IAL-të, urdhrat profesionale, institucionet dhe të tretët.

3. Shërbimet ndaj të tretëve ofrohen nga QSHA-ja pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin. QSHA-ja i ofron këto shërbime kundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. QSHA-ja ka këto funksione:

a) Koordinon procesin e aplikimit në institucionet e arsimit të lartë, për ndjekjen e studimeve në programet e ciklit të parë, atyre të integruara dhe programet profesionale;

b) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe

Sportit, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si Sekretariat Teknik i Komisionit për procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

c) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si Sekretariat Teknik i Komisionit për njohjen e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

d) Përcjell rezultatet e provimit të shtetit në ministritë e linjës, urdhrat profesionale dhe njësitë arsimore vendore.

e) Krijon dhe administron regjistrin kombëtar të studentëve të të gjitha cikleve dhe një bazë të dhënash për institucionet e arsimit të lartë, lidhur me programet e studimit, diplomat apo certifikatat që ato lëshojnë.

f) Pajis çdo student, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë me një numër unik matrikullimi, për çdo cikël studimi. Ky numër e shoqëron studentin deri në marrjen e diplomës ose certifikatës për ciklin përkatës të studimit, sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

g) Realizon studime që lidhen me provimet kombëtare dhe provimet e shtetit.

h) Merr masa për sigurinë e bazave të të dhënave që administron.

i) Ofron çdo shërbim tjetër, të lidhur me objektin e veprimtarisë së saj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe shërbime të tjera të miratuara nga Ministri përgjegjës për arsimin.

5. Çdo institucion i arsimit të lartë raporton në QSHA, programet e studimit që ofrojnë dhe diplomat apo certifikatat që ata lëshojnë, sipas procedurës të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.



6. Çdo institucion i arsimit të lartë raporton në QSHA, të gjithë aplikantët e regjistruar në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve të larta, si dhe listën e të diplomuarve sipas cikleve, brenda afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

7. Çdo urdhër profesional dhe njësi arsimore vendore raporton në QSHA, listat e kandidatëve që do t'i nënshtrohen provimit të shtetit, për çdo profesion të rregulluar sipas afateve të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

8. QSHA-ja bën publike kuotat dhe kriteret e pranimit të përcjella nga IAL-të, për të gjitha ciklet e studimit.

9. QSHA-ja lëshon diplomën e maturës shtetërore, që është dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është, dhe jepet pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore.

10. Struktura dhe organika e QSHA-së përcaktohen me urdhër nga ministri përgjegjës për arsimin në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

11. QSHA-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm.

12. Drejtori i përgjithshëm emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendimin nr.173, datë 7.3.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

13. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të QSHA-së rregullohen në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

14. QSHA-ja është institucion që financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta, si dhe ka të drejtën e administrimit të të ardhurave të krijuara, në masën 90 për qind të vitit buxhetor. Të ardhurat e papërdorura kalojnë në vitin pasardhës buxhetor.

15. Ministri përgjegjës për arsimin miraton rregulloren e funksionimit të QSHA-së.

16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, për vitin 2017, do të përballohen nga buxheti i këtij viti, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë arsimore vendore, urdhrat profesionalë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 11, datë 13.3.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.5.2010, “PËR ADMINISTRIMIN DHE DOKUMENTIMIN E PROCEDURAVE TË PAJISJEVE FISKALE”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 16, datë 3.5.2010, “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

Pika 15.4 e udhëzimit nr. 16, datë 3.5.2010, ndryshon si më poshtë:

15.4 Procedura e shitjes dhe e lëvizjes së karburanteve nga Magazinat Doganore/Fiskale.

15.4.1 Procedura e tregtimit të karburanteve nga shoqëritë sh.a., të subjektet e tregtimit me pakicë (sh.p.k.)

Tregtimi i karburanteve nga Magazina Doganore/Fiskale në pikat e tregtimit me pakicë do të kryhet në çdo rast nëpërmjet lëshimit të faturës tatimore, e cila shoqëron sasinë e karburantit të shitur. Sasia e karburantit që del nga magazina evidentohet nëpërmjet kalimatësave, të



cilët kontrollohen periodikisht nga DPM-ja. Në momentin e daljes nga Magazina Doganore/Fiskale, sasia e karburantit të shitur, përveç faturës tatimore, shoqërohet detyrimisht edhe me kuponin tatimor, i cili lëshohet nga pajisja fiskale. Kuponi i bashkëngjitet faturës tatimore për çdo dalje të karburantit (shitje të tij) dhe e shoqëron faturën tatimore gjatë të gjithë lëvizjes (transportit) nga pika e daljes nga Magazina Doganore/Fiskale, pika e shitjes me shumicë, deri në vendin e shkarkimit të karburantit në depozitat e subjektit blerës. Ai mbahet i tillë i bashkëngjitur me faturën tatimore nga blerësi.

Kuponi tatimor, i cili do t'i bashkëngjitet faturës tatimore të shitjes, duhet të përmbajë detyrimisht të regjistruar të gjitha të dhënat e kërkuara nga ky udhëzim por domosdoshmërisht të ketë referencën e faturës së lëshuar.

Subjektet e shitjes së karburantit nga Magazina Doganore/Fiskale (pika të shitjes me shumicë), janë të detyruara të raportojnë çdo ditë, me mbylljen e raportit tatimor ditor në pajisjen fiskale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me këtë udhëzim. Doganieri kontrollon në daljen e magazinës nëse kuponin tatimor i është bashkëngjitur faturës tatimore dhe nuk lejon daljen e karburantit nga Magazina Doganore/Fiskale pa u lëshuar (prerë) kuponin tatimor nga pajisja fiskale e instaluar te kalimatësi.

Subjektet transportuese të karburantit, pas daljes nga Magazina Doganore/Fiskale, qofshin këto thjesht subjekte transportuese, në pronësi të subjektit blerës apo shitës, apo vetëtransportuese, detyrohen të mbajnë të bashkëngjitur me faturën tatimore edhe kuponin tatimor që i përket blerjes së karburantit që po transportohet. Mosparaqitja gjatë kontrollit e dokumentacionit sa më sipër (faturë dhe kupon tatimor) penalizohet si moslëshim fature, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Çdo lëvizje e karburantit pa lëshimin e kuponit tatimor krahas faturës tatimore, ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe penalitete tatimore subjektin shitës me shumicë. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi administrative, punonjësën e shërbimit doganor në vendin e daljes së karburantit nga Magazina Doganore/Fiskale, nëse ai nuk kontrollon lëshimin e kuponit tatimor.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet strukturave të tyre, kryejnë kontrole të vazhdueshme e të përbashkëta për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi.

15.4.2 Procedura e tregtimit të karburanteve nga Magazina Fiskale e prodhuesit, te Magazina Fiskale e Blerësit.

Në rastin kur karburantet lëvizin nga Magazina Fiskale e Prodhuesit, te Magazina Fiskale e Blerësit, ky i fundit pajiset nga shitësi me faturë tatimore dhe kupon tatimor të gjeneruar nga pajisja fiskale. Blerësi shkarkon sasinë e karburantit të blerë në magazinën e tij fiskale dhe me pas evidenton me faturë dhe kupon tatimor çdo shitje për të tretë.

15.4.3 Procedura e lëvizjes së karburanteve nga Magazina Doganore e shoqërive të tregtimit me shumicë (sh.a.) te Magazinat Fiskale pronë e tyre.

Karburanti del nga magazina doganore me fature shoqërimi sipas standardit të miratuar nga DPT-ja, së cilës i bashkëngjitet detyrimisht kuponin tatimor i pajisjes fiskale për sasinë e nxjerrë nga kalimatësi, por domosdoshmërisht duhet të ketë referencën e faturës së shoqërimit të lëshuar. Me hyrjen e karburantit në magazinën e shoqërisë, fatura e shoqërimit, së bashku me kuponin tatimor i bashkëngjitet fletëhyrjes së magazinës së shoqërisë. Kjo lëvizje nuk konsiderohet shitje nga ana e shoqërisë së tregtimit me shumicë (sh.a.) pasi ajo është një lëvizje e brendshme e saj dhe për këtë arsye vlera e kuponit tatimor që shoqëroi faturën e shoqërimit nuk do të raportohet si shitje në raportin ditor të shitjeve të shoqërisë (pra nga shitjet gjithsej ky kupon do të zbritet).

Edhe në këtë rast, zbatohen të njëjtat penalitete sikurse në rastin e mësipërm të tregtimit të karburanteve nga magazinat doganore te pikat e tregtimit me pakicë në rastet e shkeljeve të procedurës së pajisjes me dokumentacionin e kërkuar, për vetë shoqërinë, transportuesin dhe punonjësën e shërbimit doganor.

Pika 15.5 ndryshon si më poshtë:

15.5 Procedura e importimit të karburanteve nga shoqëritë (sh.a.) nëpërmjet transportit me mjete tokësore (autobote), zhdoganimi i të cilave bëhet nëpërmjet pikave të kalimit kufitar tokësor.

15.5.1. Në këto raste, informacioni mbi sasinë e karburantit të zhdoganuar gjenerohet nga të dhënat që transferohen periodikisht cdo 24 orë nga Administrata Doganore. Në rastet kur subjekti importues e shkarkon karburantin në magazinën e



vet fiskale, çdo dalje e mëvonshme shoqërohet me kuponin e pajisjes fiskale dhe me faturën tatimore apo dokumentin shoqërues sipas rastit, kur dalja nga magazina fiskale është shitje për të tretë, apo subjekti e çon karburantin në pikën e vet të tregtimit me pakicë.

Në rastet kur subjekti importues nuk e shkarkon karburantin e importuar në magazinën e tij fiskale, por e shet direkt te subjekte të tregtimit me pakicë, për sasinë e shitur lëshon faturë tatimore, e cila përmban të njëjtën sasi karburanti të shitur, sikurse është pasqyruar në dokumentacionin e importit. Në rastet kur kryhen disa shitje, shuma e tyre duhet të korrespondojë me të dhënat e sasisë së importuar.

Për çdo shitje sipas kësaj skeme, në sistemin e raportimit *online* të DPT-së, krijohen llogari të siguruar me “emër përdoruesi”, “fjalë sekrete” dhe “firmë elektronike”. Shitësi kryen procedurën e deklarimit në serverin *online* për çdo shitje të sasisë së karburantit në pikat e tregtimit me pakicë sh.p.k., si dhe pajiset nga DPT-ja me një dokument zëvendësues të kuponit tatimor.

Autoriteti përgjegjës tatimor, në bashkëpunim me atë doganor, mbikëqyr periodikisht sasinë e deklaruar në shitje nga shoqëritë SH.A. në drejtim të shoqërive SH.P.K., duke bërë kontrole të dedikuara të inventarit dhe të sasive të shitura me pakicë nga shoqëritë SH.P.K.

15.5.2. Procedura e tregtimit nëpërmjet rishitësit të karburanteve nga magazina fiskale e prodhuesit, te pika e shitjes me pakicë (sh.p.k.) e blerësit.

Në rastin kur karburanti blihet nga kompania SH.A. që është rishitëse, dhe lëviz nga magazina fiskale e prodhuesit (shitësit) te pika e shitjes me pakicë (sh.p.k.) e karburanteve (blerësit fundorë), por lëvizja e mallrave nëpërmjet transportit nuk

kryhet në drejtim të personit të tatueshëm blerës-rishitës, por në drejtim të një personi të tretë (blerësi fundor), rishitësi blerës do të pajiset në magazinën tatimore të prodhuesit me faturë tatimore dhe kupon tatimor të gjeneruar nga pajisja fiskale e prodhuesit.

Kompania rishitëse SH.A., për sasinë e shitur te blerësi fundor, lëshon faturë tatimore, e cila përmban të njëjtën sasi karburanti të shitur, sikurse është pasqyruar në dokumentacionin e lëshuar nga prodhuesi (fatura dhe kuponi tatimor). Në rastet kur kryhen disa shitje, shuma e tyre duhet të korrespondojë me të dhënat e sasisë së blerë te prodhuesi sipas faturës dhe kuponit të lëshuar nga ai.

Për çdo rishitës sipas kësaj skeme, në sistemin e raportimit *online* të DPT-së, krijohen llogari të siguruar me “emër përdoruesi”, “fjalë sekrete” dhe “firmë elektronike”. Rishitësi kryen procedurën e deklarimit në serverin *online* për çdo rishitje të sasisë së karburantit në pikat e tregtimit me pakicë sh.p.k., si dhe pajisen me një dokument zëvendësues të kuponit tatimor.

Autoriteti përgjegjës tatimor, mbikëqyr periodikisht sasinë e deklaruar në shitje nga prodhuesi i karburanteve për shoqëritë SH.A., si dhe shitjet e këtyre të fundit në drejtim të shoqërive SH.P.K., duke bërë kontrole të dedikuara të inventarit dhe të sasive të shitura me pakicë nga shoqëritë SH.P.K.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj



Dokumenti zëvendësues i kuponit tatimor

1. Tatimpaguesit pajiset me user name password nga Drejtoria e TI ne DPT
2. Me marrjen e userit tatimpaguesi fillon deklarimin në faqen e tij në programin e paisjeve fiskale.

Në dokumentin zëvendësues të kuponit tatimor shfaqet:

deklaruesi,

destinazioni,

produktet

targa e mjetit

3. Nr.serial i dokumentit zëvendësues të kuponit tatimor është unik për çdo kupon dhe gjenerohet nga programi i paisjeve fiskale.
4. Administrata tatimore në programin e paisjeve fiskale monitoron,verifikon dhe kontrollon të gjitha deklaratimet e tatimpaguesve që deklarojnë me dokumentin zëvendësues.

Pamja e deklarimeve në programin e paisjeve fiskale për tatimpaguesit që përdorin dokumentin zëvendësues.

[illegible]

**UDHËZIM****Nr. 46, datë 28.3.2017****PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË
SIGURISË PËR PËRPUNIMIN E TË
DHËNAVE PERSONALE NËPËRMJET
SISTEMEVE TË SIGURISË, NË ZBATIM
TË LIGJIT NR. 19/2016, “PËR MASAT
SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE”**

Në mbështetje të pikës 3 dhe 4, të nenit 12, nenit 14 dhe pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim i quajtur “Komisioneri”),

UDHËZON:**Neni 1****Objekti**

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i nivelit të sigurisë që duhet të garantojnë subjektet publike dhe private gjatë përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet mjeteve të përcaktuara në nenin 8, të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Neni 2**Fusha e zbatimit**

Ky udhëzim zbatohet për të gjitha subjektet publike dhe private të cilët në kuptim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike” detyrohen të marrin masat shtesë të sigurisë sipas shkronjave “a”, “b”, të nenit 8 të këtij ligji dhe pajisen me vërtetimin e sigurisë nga autoriteti përgjegjës.

Neni 3**Përkufizime**

Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Subjekt publik dhe privat sipas ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike” nënkupton kontrolluesin e të dhënave, në kuptim të ligjit nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

“Përpunim i të dhënave” është çdo veprim që do të kryhet me të dhënat e personave, nëpërmjet masave shtesë të sigurisë.

“Përpunues i të dhënave personale” është personi i autorizuar me shkrim nga titullari i subjektit publik apo administratori i subjektit privat, i cili përpunon të dhënat personale nëpërmjet masave shtesë të sigurisë për llogari të kontrolluesit.

“Marrës i të dhënave personale” janë vetëm organet që parashikon neni 13 i ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Termat e tjerë të përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 4**Përpunimi i të dhënave personale**

1. Përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet masave shtesë të sigurisë bëhet vetëm për qëllimin e parashikuar në ligjin nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

2. Të dhënat personale që përpunohen me mjetet shtesë të përcaktuara në nenin 8/1/ “a” dhe “b”, të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”, që e bëjnë një person të identifikueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, trajtohen në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

3. Ndalohet përhapja e të dhënave me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 13 të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Neni 5**Plotësimi i njoftimit përpara përpunimit
të të dhënave personale**

Subjektet publike dhe private, pas vendosjes së masave shtesë të sigurisë dhe përpara nisjes së përpunimit të të dhënave personale, kryejnë “Njoftimin”/“Përditësimin e njoftimit” pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Zyra e Komisionerit”), sipas modelit nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, në zbatim të pikës 3 të nenit 12, të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Neni 6**Detyrimet e subjektit publik dhe privat**

1. Çdo subjekt publik dhe privat, i cili vendos masat shtesë të sigurisë, ka për detyrë:



a) para instalimit dhe vënies në funksionim të sistemeve të video survejimit, apo përdorimit të masave të tjera shtesë, të kryejë analizë të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave dhe jetën private dhe të dokumentojë atë;

b) të vendosë në ambientet e survejuara tabelën informuese, sipas modelit nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

c) të autorizojë në formë të shkruar personin/at i cili ka të drejtë të administrojë mjetin e vendosur/instaluar si masë shtesë e sigurisë, si dhe nivelin e aksesit në të dhënat e përpunuara;

d) të kërkojë plotësimin dhe nënshkrimin e “Deklaratës së konfidencialitetit” nga çdo person i autorizuar;

e) të mbajë dhe administrojë të dokumentuar veprimet e kryera gjatë përpunimit të të dhënave personale me mjetet shtesë të sigurisë;

f) të monitorojë respektimin e normave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave të automatizuara kundër prishjes së tyre aksidentale ose të paautorizuar, si dhe kundër hyrjes, ndryshimit dhe shpërndarjes së paautorizuar të tyre;

g) të lejojë ushtrimin e së drejtës së çdo personi, subjekt i të dhënave personale për të konsultuar përpunimin e të dhënave përkatëse dhe të dokumentojë mbi këtë të drejtë;

h) të hartojë rregulla të shkruara për vendosjen e masave shtesë të sigurisë, përpunimin e të dhënave personale, personat e lejuar për të aksesuar bazën e të dhënave, kohën e ruajtjes së të dhënave, si dhe mënyrën e shkatërrimit të tyre;

i) të sigurojë që këndi i vrojtimit të kamerave të sistemit të video survejimit të jetë i tillë që të filmojë pamje brenda qëllimit për të cilin është instaluar sistemi;

j) të sigurojë që çdo transmetim në rrjet i të dhënave të bëhet në formë të koduar me të drejtë aksesit të plotë vetëm nga dhënësit dhe marrësit e tyre;

k) të përcaktojë në rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, nivelet e aksesit për kategoritë e atyre që aksesojnë, ndërveprimin e bazës së të dhënave etj.

Neni 7

Personi i autorizuar për përpunimin dhe administrimin e të dhënave personale

1. Personi i autorizuar, duhet të jetë i njëjtë me personin e ngarkuar në kuptim të ligjit nr. Faqe | 3696

9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

2. Personi i autorizuar, duhet:

a) të informojë Zyrën e Komisionerit brenda 48 orëve në rast kompromentimi, manipulimi ose modifikimi të paautorizuar të sistemit;

b) të informojë Zyrën e Komisionerit për përhapjen e të dhënave personale sipas nenit 13 të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

3. Komunikimet me Zyrën e Komisionerit bëhen në formë shkresore ose në adresën e postës elektronike.

Neni 8

Politika e vëzhgimit me kamera

1. Politika e vëzhgimit me kamera publikohet në faqen zyrtare të subjektit publik ose privat në një format lehtësisht të lexueshëm.

2. Politika e vëzhgimit me kamera, duhet:

a) të përshkruajë qëllimin dhe përdorimin e sistemit, përpunimin që i bën të dhënave personale dhe masat e sigurisë;

b) të specifikojë konfirmimin e pajtueshmërisë me ligjin nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe udhëzimet e miratuara nga Komisioneri;

c) të përshkruajë masat e zbatuara;

